



Krimet e përgjithshme 2025

(Analizë e trajtimit të rasteve në Departamentet e Përgjithshme -
Divizionet Penale të prokurorive dhe gjykatave)



Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të: Anesa Hoxha, Zamira Krasniqi dhe Flamur Kabashi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorinë e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Prill, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	6
2. Metodologjia	9
3. Ngarkesa e prokurorive.....	10
4. Ngarkesa dhe efikasiteti i prokurorëve sipas prokurorive	11
5. Shpejtësia e reagimit të Prokurorit të Shtetit	17
5. Sekuestrimi dhe konfiskimi	18
6. Roli i Prokurorit të Shtetit në Politikën Ndëshkimore.....	19
7. Ngarkesa e gjykatave	21
8. Ngarkesa dhe efikasiteti i Gjyqtarëve sipas Gjykatave.....	22
9. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në shkallë të parë.....	26
10. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në Gjykatë të Apelit	27
11. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve	28
11.1. Në Gjykatat Themelore.....	28
11.2. Në Gjykatën e Apelit	29
12. Aplikimi i jurisprudencës së GJEDNJ në rastet e Gjykatave	30
13. Vendosja për kërkesën pasurore juridike.....	31
14. Dënimet plotësuese	33
15. Politika ndëshkimore	34
15.1. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në DP gjatë vitit 2025	35
15.2. Analiza e aktgjytimeve të Apelit sa i përket zbatimit të Udhëzuesit të Supremes.....	37

Lista e shkurtesave

IKD	–	Instituti i Kosovës për Drejtësi
GJEDNJ	–	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	–	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	–	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	–	Këshilli Prokurorial i Kosovës
GJK	–	Gjykata Kushtetuese
DP	–	Departamenti i Përgjithshëm
PTh	–	PTH
GjTh	–	Gjykata Themelore

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet trendet dhe praktikat e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të cilat trajtohen në departamentet e përgjithshme të prokurorive dhe departamenteve të përgjithshme – divizioneve penale të gjykatave në Kosovë gjatë vitit 2025. I bazuar në analizën e 50 aktakuzave, 200 aktgjykimeve të gjykatave themelore dhe 100 aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit si dhe konsultime me të gjithë akterët relevant, raporti paraqet gjendjen sa i përket ngarkesës, efikasitetit, kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve, politikën ndëshkimore dhe gjetje tjera relevante.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore gjatë vitit 2025 janë përballur me ngarkesë të lartë dhe me rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Pothuajse të gjitha prokuroritë kanë operuar me bilanc negativ, me përjashtim të PTH në Pejë. Po ashtu, edhe pse në nivel vendi norma orientuese për prokuror është arritur, kjo nuk është reflektuar në mënyrë të barabartë në të gjitha prokuroritë.

Përveç kësaj, IKD ka analizuar edhe shpejtësinë e reagimit të Prokurorit të Shtetit, rolin e tij në politikën ndëshkimore si dhe sekuestrimit dhe konfiskimin. Gjetjet dëshmojnë se, me disa përjashtime, Prokurori i Shtetit ka reaguar relativisht shpejt në ngritjen e aktakuzave. Megjithatë, zbatimi i masës së sekuestrimit dhe konfiskimit mbetet i kufizuar. Në anën tjetër, kontributi i Prokurorit të Shtetit në politikën ndëshkimore vazhdon të jetë kryesisht formal. Në shumicën e rasteve, rrethanat lehtësuese dhe rënduese ose nuk janë përfshirë fare, ose janë përfshirë pa një elaborim të mirëfilltë, ndërsa Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore mbetet fare pak i aplikuar në aktakuzat e ngritura.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se departamentet e përgjithshme – divizionet penale të gjykatave themelore kanë arritur ulje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2025. Megjithatë, edhe në rastin e gjykatave, dallimet në ngarkesë dhe në efikasitet ndërmjet tyre mbeten të theksuara. Për më tepër, ulja e numrit të lëndëve të pazgjidhura nuk nënkupton domosdoshmërisht tejkalim të problemeve në efikasitet, pasi kohëzgjatja e trajtimit të rasteve vazhdon të mbetet e lartë.

Sa i përket vjetërsisë së lëndëve dhe kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve, gjetjet tregojnë se në gjykata themelore vazhdojnë të trajtohen raste shumë të vjetra, përfshirë raste me aktakuza të ngritura para më shumë se një dekade. Veç kësaj,

mesatarja e trajtimit të rasteve në shkallë të parë mbetet e lartë, ndërsa kur kësaj i shtohet edhe trajtimi në Gjykatën e Apelit, rezulton se procedura penale zgjat mesatarisht rreth dy vjet e pesë muaj deri në nxjerrjen e një aktgjykimi të formës së prerë.

IKD ka analizuar edhe aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj-së, vendosjen për kërkesën pasurore juridike dhe përdorimin e dënimeve plotësuese. Gjetjet dëshmojnë se jurisprudenca e GjEDNj-së pothuajse nuk aplikohet fare në aktgjykimet e analizuara, kërkesa pasurore juridike trajtohet shumë rrallë, ndërsa dënimet plotësuese mbetin përjashtim e jo praktikë e rregullt gjyqësore. Kjo tregon se përkundër bazës ligjore ekzistuese, një pjesë e rëndësishme e instrumenteve që ndikojnë në efikasitetin, efektivitetin dhe cilësinë e gjyimit penal nuk përdoren në masë të mjaftueshme.

Sa i përket analizës që IKD ka bërë për politikën ndëshkimore në aktgjykimet e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, gjetjet dëshmojnë se në shumë raste gjykatat vazhdojnë të përdorin arsyetime të përgjithshme dhe pa individualizim të mjaftueshëm të dënimit, përfshirë edhe raste të aplikimit të dyfishtë të rrethanave lehtësuese. Po ashtu, edhe Gjykata e Apelit, në rastet e analizuara, nuk ka vepruar ndryshe nga shkalla e parë, duke lënë në fuqi aktgjykime edhe kur janë vërejtur mangësi në arsyetim dhe në zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për matjen e dënimit.

Përfundimisht, ky raport dëshmon se sfida kryesore e departamenteve të përgjithshme nuk mbetet vetëm sasia e lëndëve që trajtohen, por edhe shumë faktorë të tjerë të cilët duhet fuqizuar në periudhat pasuese.

2. Metodologjia

Ky raport është bazuar në analizën e praktikës së ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të trajtuara nga departamentet e përgjithshme të prokurorive dhe gjykatave në Kosovë gjatë vitit 2025. Me qëllim të gjenerimit të gjetjeve sa më reale, IKD ka përdorur një metodologji të përzier të hulumtimit dhe analizimit.

Ky raport është draftuar mbi bazën e gjetjeve të gjeneruara nga analiza e aktakuzave dhe aktgjykimeve në rastet e departamenteve të përgjithshme të prokurorive dhe gjykatave.

Me qëllim të pasqyrimin të drejtë të gjendjes dhe gjenerimit të gjetjeve adekuate, analiza e këtyre akteve është bërë mbi bazën e një seti të paracaktuar të indikatorëve.

Për qëllime të këtij raporti, janë analizuar gjithsej:

- 50 aktakuza të ngritura nga prokuroritë themelore në Kosovë;
- 200 aktgjykime dënuese të nxjerra nga gjykatat themelore;
 - 50 aktgjykime dënuese nga Gjykata Themelore në Prishtinë;
 - nga 25 aktgjykime nga gjashtë (6) gjykatat tjera themelore.
- 100 aktgjykime të nxjerra nga Gjykata e Apelit.

Aktakuzat janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike drejtuar prokurorive themelore në Kosovë. Përzgjedhja e tyre është bërë nga vetë prokuroritë, e që në Prokurorinë Themelore në Prishtinë janë siguruar 14 aktakuza, derisa në prokuroritë tjera janë siguruar nga 6 aktakuza për secilën. Ndërkaq, aktgjykimet janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga vendimet e publikuara në faqen zyrtare në internet të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Analiza përfshin raste të natyrave të ndryshme penale të trajtuara nga departamentet e Përgjithshme gjatë vitit 2025. Në kuadër të kësaj analize janë shqyrtuar efikasiteti dhe ngarkesa e institucioneve, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve, aplikimi i dispozitave ligjore dhe standardeve gjyqësore, praktikat e ndjekjes penale dhe të vendimmarrjes gjyqësore etj.

Në anën tjetër, pjesë e këtij raporti janë edhe intervistat me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët, të cilat janë realizuar nga ana e IKD-së dhe medias “*Betimi për Drejtësi*”. Për më tepër, me qëllim të gjithëpërfshirjes, ky raport është ndarë për komente me të gjithë akterët relevantë, para publikimit të tij.

3. Ngarkesa e prokurorive

Departamentet e Përgjithshme të Prokurorive Themelore vitin 2025 e kanë filluar me gjithsej 21,617 lëndë të pazgjidhura, ndërsa në fund të nëntëmujorit të vitit të njëjtë, ky numër ka arritur në 23,545. Kjo tregon se gjatë kësaj periudhe këto departamente nuk kanë arritur të zgjidhin aq lëndë sa kanë pranuar, duke rezultuar në rritje të numrit të lëndëve në fund të periudhës raportuese.

Në përgjithësi, pothuajse të gjitha Prokuroritë Themelore kanë operuar me bilanc negativ, përkatësisht kanë zgjidhur më pak lëndë sesa kanë pranuar. Përfundimisht bën vetëm PTH në Pejë, e cila ka arritur të zgjidhë 192 lëndë më shumë sesa ka pranuar, duke qenë e vetmja prokurori me bilanc pozitiv gjatë periudhës raportuese.

Ngarkesa më e madhe vazhdon të mbetet në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, e cila jo vetëm që ka pasur numrin më të madh të lëndëve në punë, por ka shënuar edhe rritjen më të lartë të lëndëve të pazgjidhura. Rritje të lëndëve të pazgjidhura janë evidentuar edhe në prokuroritë tjera, çka tregon se problemi i menaxhimit të ngarkesës nuk është i kufizuar vetëm në një prokurori.

Prokuroria	Lëndë të pazgjidhura në fillim 2025	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të Zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund	Diferenca
Prishtina	7675	6184	13859	5216	8643	+968
Prizren	1564	2723	4287	2359	1928	+364
Pejë	3035	2832	5867	3024	2843	-192
Ferizaj	1506	2047	3553	2026	1527	+21
Mitrovica	5134	1794	6928	1529	5399	+265
Gjakovë	2432	1900	4332	1609	2723	+291
Gjilan	271	1874	2145	1663	482	+211
Total	21617	19354	40971	17426	23545	+1928

Tabela 1: Ngarkesa e DP të PTh-ve në nëntëmujorin e parë të vitit 2025¹

¹ **Shënim:** Te dhënat e paraqitura në tabela sa i përket ngarkesës së prokurorive dhe prokurorëve janë vetëm për 9-mujorin e vitit 2025.

4. Ngarkesa dhe efikasiteti i prokurorëve sipas prokurorive

Sa i përket ngarkesës me lëndë, në nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2025, në nivel vendi, i bie që një prokuror ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 519 lëndë. Megjithatë, kjo mesatare nuk reflektohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha Prokuroritë Themelore, pasi dallimet ndërmjet tyre janë të theksuara.

Në disa prokurori, ngarkesa për prokuror është dukshëm më e lartë se mesatarja. Kjo vërehet veçanërisht në Mitrovicë dhe Gjakovë, ku një prokuror ka pasur mesatarisht 866 lëndë në punë, si dhe në Pejë me 652 lëndë për prokuror. Ndërkaq, në disa prokurori tjera, ngarkesa për prokuror është më e ulët se mesatarja në nivel vendi. PTH në Gjilan paraqitet me ngarkesën më të ulët prej 268 lëndësh për prokuror, pasuar nga Prizreni me 330 dhe Ferizaj me 395 lëndë për prokuror. PTH në Prishtinë, ndonëse ka numrin më të madh absolut të lëndëve në punë, ka një ngarkesë mesatare prej 513 për prokuror që është afër mesatares në nivel vendi.

Me qëllim të balancimit të ngarkesës ndërmjet prokurorive, KPK duhet të shqyrtoj mundësinë e transferimit të përkohshëm apo të përhershëm të prokurorëve nga prokuroritë me ngarkesë më të ulët drejt atyre me ngarkesë më të lartë. Një qasje e tillë do të mundësonte shpërndarje më të drejtë të lëndëve, balancim të ngarkesës dhe përmirësim të efikasitetit në trajtimin e rasteve në departamentet e përgjithshme.

Prokuroria	Lëndë në punë gjatë vitit 2025	Numri i prokurorëve	Mesatarja e lëndëve në punë
Prishtina	13859	27	513
Prizren	4287	13	330
Pejë	5867	9	652
Ferizaj	3553	9	395
Mitrovica	6928	8	866
Gjakovë	4332	5	866
Gjilan	2145	8	268
Total	40971	79	519

Tabela 2. Krahasimi i numrit të lëndëve me numrin e prokurorëve

Ndërkaq, sa i përket efikasitetit, gjetjet tregojnë se edhe niveli i zgjidhjes së lëndëve dallon ndjeshëm ndërmjet prokurorive themelore. Në nivel vendi, një prokuror i departamenteve të Përgjithshme ka zgjidhur mesatarisht 221 lëndë gjatë nëntëmuorit të vitit 2025. Megjithatë, sikurse edhe te ngarkesa, kjo mesatare nuk reflektohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha prokuroritë.

Efikasiteti më i lartë vërehet në Prokurorinë Themelore në Pejë, në të cilën një prokuror ka zgjidhur mesatarisht 336 lëndë, pasuar nga Gjakova me 322 lëndë të zgjidhura për prokuror. Këto dy prokurori jo vetëm që rezultojnë me efikasitetin më të lartë, por njëkohësisht janë edhe ndër prokuroritë me ngarkesën më të lartë për prokuror.

Në anën tjetër, efikasitet më i ulët vërehet në Prizren, Prishtinë dhe Mitrovicë, ku numri mesatar i lëndëve të zgjidhura për prokuror mbetet nën mesataren në nivel vendi. Veçanërisht, PTH në Mitrovicë paraqitet me ngarkesë shumë të lartë për prokuror, por me numër relativisht të ulët të lëndëve të zgjidhura, çka tregon disproporcion ndërmjet barrës së punës dhe rezultatit të arritur.

Prokuroria	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2025	Numri i prokurorëve	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
Prishtina	5216	27	193
Prizren	2359	13	181
Pejë	3024	9	336
Ferizaj	2026	9	225
Mitrovica	1529	8	191
Gjakovë	1609	5	322
Gjilan	1663	8	208
Total	17426	79	221

Tabela 3. Krahasimi mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të prokurorëve

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2025 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit, një Prokurori në departamentet e përgjithshëm të prokurorive themelore brenda një viti duhet të zgjidhë 198 lëndë penale.

Në linjë me këtë, gjetjet e IKD-së dëshmojnë se norma orientuese prej 198 lëndësh të zgjidhura në vit për një prokuror, e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2025, në përgjithësi është arritur në nivel vendi, pasi mesatarja e lëndëve të zgjidhura për prokuror në departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore gjatë vitit 2025 ka qenë 221. Megjithatë, kjo normë nuk është përmbushur në mënyrë të barabartë në të gjitha prokuroritë. Derisa Prokuroritë Themelore në Pejë, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan e kanë tejkaluar normën orientuese, Prokuroritë Themelore në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë kanë mbetur nën këtë standard.

Nisur nga fakti se rënia nën këtë standard nuk është shumë e lartë, në këtë gjendje kanë pasur mundësi të ndikojnë disa faktorë. Faktori i parë është se një pjesë e prokurorëve janë me mandat fillestar. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2025, prokurorët e departamenteve të përgjithshme gjatë trajnimit fillestar, brenda një viti, janë të obliguar të përfundojnë 88 lëndë, për dallim nga ata me mandat të plotë që janë të obliguar të zgjidhin 198 lëndë.

Edhe në këtë rast, në efikasitetin e prokurorive ka mundur të reflektoj edhe fakti se disa prej prej prokurorëve të angazhuar në këto departamente kanë qenë me mandat fillestar.

Numri i prokurorëve me mandat fillestar gjatë vitit 2025 paraqitet në tabelën në vijim:

Prokuroria	Prokurorë me mandat fillestar
Prishtina	15
Prizren	6
Pejë	4
Ferizaj	6
Mitrovica	4
Gjakovë	9
Gjilan	6
Total	50

Tabela 4. Numri i prokurorëve me mandat fillestar gjatë vitit 2025

Ndërsa, sa i përket efikasitetit të përgjithshëm, kanë mundur të ndikojnë edhe lëvizjet e prokurorëve brenda periudhës raportuese.

Për këtë raport të dhënat lidhur me numrin e lëndëve dhe numrin e prokurorëve janë marrë nga raporti nëntëmujor i punës së prokurorive për vitin 2025². Megjithatë, bazuar në komentet e pranuar nga prokuroritë themelore, në disa raste numri i paraqitur i prokurorëve nuk pasqyron në mënyrë të plotë numrin e prokurorëve që kanë qenë realisht të angazhuar gjatë gjithë kësaj periudhe në trajtimin e rasteve në departamentet e përgjithshme.

² "Raporti nëntëmujor i punës së prokurorit të Shtetit – Janar-Shtator 2025". Zyra e Prokurorit të Shtetit. Dhjetor 2025.

Në këtë drejtim, nga PTH në Prishtinë është theksuar se gjatë periudhës raportuese kanë ekzistuar rrethana të ndryshme që kanë ndikuar në angazhimin efektiv të prokurorëve në trajtimin e rasteve. Sipas këtij institucioni, numri i përgjithshëm i prokurorëve i paraqitur në raportin nëntëmujor nuk nënkupton domosdoshmërisht se të gjithë këta prokurorë kanë qenë gjatë gjithë kohës të angazhuar në mënyrë të plotë në departamentet e përgjithshme. Kjo pretendohet se ka ndodhur për shkak të faktorëve si lëvizjet brenda institucionit, angazhimet në departamente të tjera, si dhe rrethana të tjera operative që ndikojnë në shpërndarjen e punës.

Gjithashtu, edhe nga PTH në Prizren është theksuar se numri i prokurorëve i paraqitur në raportin nëntëmujor nuk pasqyron në mënyrë të plotë gjendjen faktike gjatë vitit 2025. Sipas kësaj Prokurorie, ndonëse në fillim të vitit, Departamenti i Përgjithshëm ka pasur 13 prokurorë, gjatë vitit ky numër është reduktuar ndjeshëm si rezultat i pensionimit, avancimeve, transferimeve dhe pezullimit nga detyra të disa prokurorëve, duke rezultuar që në një periudhë të konsiderueshme të vitit të operohet me një numër dukshëm më të ulët të prokurorëve. Veç kësaj, kjo Prokurori ka theksuar se prokurorët e sapoemëruar me mandat fillestar kanë pasur ngarkesë të kufizuar fillestare, çka gjithashtu ka ndikuar në kapacitetin e përgjithshëm për trajtimin e lëndëve. Në këtë kontekst, sipas këtij institucioni, reduktimi i numrit të prokurorëve ka ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve gjatë periudhës raportuese.

Ndërsa, nga intervistat me kryeprokurorë të prokurorive themelore, të realizuara nga "*Betimi për Drejtësi*", numri i pamjaftueshëm i prokurorëve del të jetë një prej problematikave që ka ndikim të drejtpërdrejt në ngarkesën e prokurorive me lëndë. Rrjedhimisht, përgjatë intervistave u përmendën edhe kërkesat për rritjen e numrit të prokurorëve.³ Kryeprokurori i PTH në Gjakovë, Enis Gashi, ka theksuar

³ Intervista kryeprokurorin e PTH në Gjakovë, Enis Gashi & IKD "*Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Gjakovë*". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-gjakove/?fbclid=IwY2xjawRUR3xleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhchBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHrLAv4Vf2gd9OTN0QA69vk4w2lrC4Wwx23HMDdEhd01XZvw0YGP0dYC2kQjFb_aem_BampUcPYfiEt8yBMBRCqIw); Intervista me U.D Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Nijazi Rexha, & IKD "*Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë*". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-mitrovice/?fbclid=IwY2xjawRUSAVleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHhY5WgboB5BX4-080Uym9li173O91zS7WbDcCa0LIBuB1123pO2S4YJxjJKF_aem_3Bywbp0BnfN-MsaWgTmDrA).

Intervista me kryeprokurorin e PTH në Prishtinë, Zejnullah Gashin & IKD "*Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prishtinë*". (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prishtine>).

se aktualisht janë duke funksionuar me nëntë (9) prokurorë, ndërkohë që vlerësoi se kjo Prokurori do duhej të ketë rreth 15 prokurorë.⁴ Po ashtu, kryeprokurorja e PTH në Pejë, Lumturije Vuçetaj, bëri të ditur se ka parashtruar një kërkesë për të paktën edhe katër prokurorë shtesë.⁵

Ndërsa, kryeprokurori i PTH në Prizren, Petrit Kryeziu, deklaroi se aktualisht janë minus pesë prokurorë. Sipas tij, deri në vitin tjetër do jenë minus tetë prokurorë për shkak të daljes në pension të tre prokurorëve.⁶

Sipas ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Nijazi Rexha, ngarkesa e lartë me lëndë në këtë prokurori paraqet një problem të

[ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prishtine/?fbclid=IwY2xjawRUSVbleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoRMu79OzS5p_7LseXslC7uLeKprMLa8yRH4a0MMmu1HMbY-Jx6_MdGcst24_aem_9xLGviviwyV_lu1uJoBTMNA](https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prishtine/?fbclid=IwY2xjawRUSVbleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoRMu79OzS5p_7LseXslC7uLeKprMLa8yRH4a0MMmu1HMbY-Jx6_MdGcst24_aem_9xLGviviwyV_lu1uJoBTMNA); Intervista me kryeprokuroren e PTH në Pejë, Lumturije Vuçetaj. & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Pejë”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-peje/?fbclid=IwY2xjawRUSkhleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHmFtt7QvNoRU0AiOxG_Ke-Rtc-MUEuBZqIK6GL2MKniUNKz56V1W4ZGvke2d_aem_B3md3LrZHcblhowbLPDKjA); Intervista me kryeprokurorin e PTH në Prizren, Petrit Kryeziun, & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prizren”. (shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prizren/?fbclid=IwY2xjawRUSZ5leHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHsrJFoArjlxAbOOZCSyYXDXJSfHVwbAcYQYE2g8_XWQgw06hAn9WBKM-63-aem_iHuOgxz0wzm2LbDZ1PggaA).

⁴ Intervista kryeprokurorin e PTH në Gjakovë, Enis Gashi & IKD “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Gjakovë”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-gjakove/?fbclid=IwY2xjawRUR3xleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHrLAv4Vf2gd9OTN0QA69vk4w2lrc4Wwx23HMDEhd01XZvw0YGp0dYC2kQjFb_aem_BampUcPYfiEt8yBMBCRqIw);

⁵ “Kryeprokurorja e Pejës: Përfunduar 104% të lëndëve”. Betimi për Drejtësi. 21 mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurorja-e-pejes-perfunduar-104-te-lendeve/>) & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Pejë”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-peje/?fbclid=IwY2xjawRUSkhleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHmFtt7QvNoRU0AiOxG_Ke-Rtc-MUEuBZqIK6GL2MKniUNKz56V1W4ZGvke2d_aem_B3md3LrZHcblhowbLPDKjA).

⁶ “Kryeprokurori Kryeziu: Kemi nevojë për një objekt të Prokurorisë dhe rritjen e numrit të prokurorëve”. Betimi për Drejtësi. 06 Prill 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-kryeziu-kemi-nevoje-per-nje-objekt-te-prokurorise-dhe-rritjen-e-numrit-te-prokurorëve/>). & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prizren”. (shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prizren/?fbclid=IwY2xjawRUSZ5leHRuA2FlbQIxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHsrJFoArjlxAbOOZCSyYXDXJSfHVwbAcYQYE2g8_XWQgw06hAn9WBKM-63-aem_iHuOgxz0wzm2LbDZ1PggaA).

akumuluar ndër vite, i ndikuar nga rrethana strukturore dhe zhvillime specifike institucionale, përfshirë periudhën pas vitit 2008, kur sistemi i drejtësisë në këtë rajon ka funksionuar me kapacitete të kufizuara. Ai thekson se situata është rënduar veçanërisht pas vitit 2022, kur pas dorëheqjes së prokurorëve serbë, prokuroria ka operuar me kapacitete minimale, duke rezultuar që një prokuror të ketë në punë deri në rreth 1,000 lëndë dhe duke krijuar rrezik të konsiderueshëm të parashkrimit të rasteve.

Sipas tij, sfidat në funksionim kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2025, përfshirë vështirësitë në përfaqësim në seanca gjyqësore për shkak të disproporcionit ndërmjet numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.⁷

Derisa, u përgjatë këtyre intervistave u përmend edhe fakti se jo të gjithë prokurorët kanë bashkëpunëtor profesional.⁸

5. Shpejtësia e reagimit të Prokurorit të Shtetit

Sa i përket trajtimit të rasteve, IKD ka analizuar edhe shpejtësinë e reagimit të Prokurorit të Shtetit, në kuptim të kohës ndërmjet vitit kur dyshohet të jetë kryer vepra penale dhe vitit kur është ngritur aktakuza. Kjo pasi, sikurse gjykimi, edhe ndjekja penale duhet të karakterizohet nga efikasiteti dhe reagimi brenda një kohe të arsyeshme. Në këtë drejtim, nga aktakuzat e analizuara rezulton se me

⁷ Intervista me U.D Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Nijazi Rexha, & IKD ” *Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë*”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-mitrovice/?fbclid=IwY2xjawRUSAVleHRuA2FlbQlXMAbicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQOMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHhY5WgboB5BX4-080Uym9Ii173O91zS7WbDcCa0LiBuB1I23pO2S4YJxjJKF_aem_3Bywbp0BnfN-MsaWgTmDrA).

⁸ “*Kryeprokurorja Vuçetaj: 89.3% të aktakuzave kanë përfunduar me aktgjykim*”. Betimi për Drejtësi. 21 Mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurorja-vucetaj-89-3-te-aktakuzave-kane-perfunduar-me-aktgjykim-denuesebottom-of-form/>), & IKD, “*Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Pejë*”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-peje/?fbclid=IwY2xjawRUSkhleHRuA2FlbQlXMAbicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQOMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHmFtt7QvNoRU0AiOxG_Ke-Rtc-MUEuBZqIK6GL2MKniUNKz56V1W4ZGvkE2d_aem_B3md3LrZHcblhowbLPDKjA); “*Kryeprokurori Gashi thotë se nga drejtori i sekretariatit kuptoi që rreth 8 milionë euro borxh ka Sistemi Prokurorial*”. Betimi për Drejtësi. 4 Prill 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-gashi-thote-se-nga-drejtori-i-sekretariatit-kuptoi-qe-rreth-8-milione-euro-borxh-ka-sistemi-prokurorial/>) & IKD “*Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prishtinë*”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prishtine/?fbclid=IwY2xjawRUSVbleHRuA2FlbQlXMAbicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQOMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHhOrMu79OzS5p_7LseXslC7uLeKprMLa8yRH4a0MMmu1HMbY-Jx6_MdGest24_aem_9xLGvivyV_Iu1uJoBTMNA).

disa përjashtime, Prokurori i Shtetit ka vepruar me efikasitet në raport me veprat penale për të cilat ka ngritur aktakuzë.

Të dhënat tregojnë se shumica dërrmuese e aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2025 kanë të bëjnë pikërisht me veprat penale që dyshohet të jenë kryer gjatë të njëjtit vit. Ndërkaq, evidentohen edhe raste kur janë ngritur aktakuza për vepra penale të cilat dyshohet të jenë kryer në vitin 2020 apo 2021. Megjithatë, në raport me mostrën e përgjithshme, të dhënat tregojnë se me disa përjashtime, në shumicën e rasteve, reagimi i Prokurorit të Shtetit ka qenë relativisht i shpejtë, duke adresuar në kohë përgjegjësinë penale për veprat e dyshuara penale.

Viti kur dyshohet të jetë kryer vepra penale	Numri i aktakuzave
2020	3
2021	1
2023	1
2024	12
2025	33

Tabela 5. Vitet kur e kryerjes së veprave penale në aktakuzat e ngritura gjatë vitit 2025

5. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Sekuestrimi dhe konfiskimi përbëjnë mekanizma të rëndësishëm në luftimin e kriminalitetit, pasi që përmes tyre synohet privimi i kryerësve nga dobia pasurore e përfituar nga veprat penale dhe parandalimi i përfitimeve të mëtejshme. Megjithatë, këto masa nuk janë të aplikueshme në çdo rast penal, pasi që zbatimi i tyre varet nga natyra e veprës penale dhe ekzistimi i pasurisë apo sendeve që lidhen me veprën. Duke pasur parasysh këtë çështje dhe këtë kufizim, IKD ka analizuar përdorimin e këtyre masave në aktakuzat e departamenteve të përgjithshme gjatë vitit 2025.

Nga analizimi i 50 aktakuzave të departamenteve të përgjithshme të prokurorive themelore të ngritura gjatë vitit 2025, të dhënat tregojnë se vetëm në 16 raste Prokurori i Shtetit ka parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim, derisa këtë nuk e ka bërë në 34 raste. Shprehur në përqindje, rezulton se kërkesa për

sekuestrim dhe konfiskim është paraqitur në 32% të rasteve, ndërsa në 68% të rasteve një kërkesë e tillë ka munguar.

Këto të dhëna tregojnë se kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim vazhdojnë të mos përdoren në masën e duhur nga Prokurori i Shtetit. Rrjedhimisht, edhe në rastet kur ekziston mundësia për të kërkuar sekuestrimin apo konfiskimin e dobisë pasurore apo sendeve që lidhen me veprën penale, kjo mundësi nuk është shfrytëzuar në mënyrë të mjaftueshme. Për këtë arsye, fokusi i Prokurorit të Shtetit duhet të jetë dukshëm më i madh në luftimin e kriminalitetit përmes sekuestrimit dhe konfiskimit, në rastet kur kjo është e mundur.

Është parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim	Nuk është parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim
16 raste	34 raste ⁹

Tabela 6. Rastet kur është parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim

Megjithatë, duhet theksuar se, përkundër faktit që natyra e rasteve të trajtuara në departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore lidhet kryesisht me vepra penale me rrezikshmëri më të ulët, kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim kanë qenë më të shpeshta sesa në rastet e korrupsionit. Kjo për faktin se në rastet e korrupsionit, IKD ka gjetur se një kërkesë e tillë është paraqitur në vetëm 19% të rasteve¹⁰. Kjo nënkupton se, ndonëse niveli i përdorimit të sekuestrimit dhe konfiskimit edhe në departamentet e përgjithshme mbetet i ulët, ai gjithsesi rezulton më i lartë krahasuar me rastet e korrupsionit.

6. Roli i Prokurorit të Shtetit në Politikën Ndëshkimore

Me qëllim të avancimit të politikës ndëshkimore, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i ka dhënë rol Prokurorit të Shtetit qysh në fazën e ngritjes së aktakuzës. Neni 235 paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 përcakton se aktakuza duhet të përmbajë propozimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të njohura në kohën e dorëzimit të saj, të cilat mund të jenë relevante për marrjen e vendimit të duhur. Në këtë drejtim, IKD ka gjetur se në shumicën e rasteve ky obligim është

⁹ **Shënim:** Në këto raste të analizuar janë të përfshira edhe aktakuza të ngritura për vepra penale për të cilat nuk është paraparë sekuestrimi apo konfiskimi.

¹⁰ Shala G. “Përformanca e Drejtësisë në ndjekjen dhe gjykimin e korrupsionit”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 19. Prishtinë. Dhjetor 2025. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2025/12/1.-ALB-Performanca-e-drejtësisë-ne-ndjekjen-dhe-gjykimin-e-korrupsionit.pdf>).

përmbushur vetëm formalisht në aktakuzat e ngritura nga departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore.

Nga 50 aktakuza të analizuara, në 37 raste Prokurori i Shtetit ka listuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ndërkaq në 13 raste ato nuk janë listuar fare. Kjo nënkupton se në një pjesë të rasteve janë ngritur aktakuza pa u përmbushur në tërësi njëri prej elementeve që kërkohet shprehimisht me ligj.

Megjithatë, edhe në rastet kur këto rrethana janë listuar, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht se ato janë trajtuar në mënyrë substanciale. Të dhënat tregojnë se vetëm në 14 raste rrethanat lehtësuese dhe rënduese janë elaboruar, ndërsa në 23 raste ato vetëm janë përmendur, pa ndonjë arsytim apo shpjegim shtesë. Kjo tregon se kontributi i Prokurorit të Shtetit në këtë aspekt, në shumicën e rasteve, mbetet në nivel formal dhe jo substancial.

Rrjedhimisht, IKD ka analizuar edhe kontributin e Prokurorit të Shtetit në zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore. Gjetjet nga analiza e aktakuzave tregojnë se ky udhëzues është cituar vetëm në dhjetë (10) raste, prej të cilave në pesë (5) raste është përmendur në mënyrë të përgjithshme dhe në pesë (5) raste në mënyrë më specifike. Ndërkaq, në 40 raste aktakuzat nuk e kanë cituar fare këtë udhëzues.

Kështu, del se roli i Prokurorit të Shtetit në avancimin e politikës ndëshkimore nuk është shfrytëzuar në masën e duhur qysh në fazën e ngritjes së aktakuzës. Përkundër bazës së qartë ligjore, në shumicën e rasteve rrethanat lehtësuese dhe rënduese ose nuk janë përfshirë fare, ose janë përfshirë vetëm formalisht, pa elaborim të mirëfilltë. Po ashtu, edhe referimi në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore mbetet i kufizuar, çka tregon se dispozita e re në Kodin e Procedurës Penale ende nuk shfrytëzohet në mënyrë adekuate nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Nuk ka listuar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	13 raste
Ka listuar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	37 raste
Ka elaboruar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	14 raste ka elaboruar
Nuk ka elaboruar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	23 raste
Ka cituar Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore	10 raste ka përmendur
- Në mënyrë të përgjithshme	5 raste
- Në mënyrë specifike	5 raste
Nuk ka cituar Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore	40

Tabela 7. Zbatimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore

7. Ngarkesa e gjykatave

Departamentet e përgjithshme të gjykatave themelore, vitin 2025 e kanë filluar me gjithsej 28,159 lëndë të pazgjidhura, ndërsa në fund të vitit ky numër ka rënë në 27,844. Kjo tregon se gjatë kësaj periudhe, këto departamente kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë sesa që kanë pranuar, duke rezultuar në ulje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

Në këtë drejtim, bilanc pozitiv kanë shënuar Gjykatat Themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan, ndërsa uljen më të madhe të numrit të lëndëve të pazgjidhura e ka shënuar Gjykata Themelore në Mitrovicë, me 365 lëndë më pak.

Ndërkaq, jo të gjitha gjykatat kanë arritur të ruajnë këtë trend. Gjykatat Themelore në Prizren, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë kanë zgjidhur më pak lëndë sesa kanë pranuar, duke rezultuar me rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Rritja më e

theksuar vërehet në Gjykatën Themelore në Prizren, me 233 lëndë më shumë, pasuar nga Peja me 192, Ferizaj me 162 dhe Gjakova me 53 lëndë më shumë në fund të vitit.

Gjykata	Lëndë të pazgjidhura në fillim 2025	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të Zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund	Diferenca
Prishtina	12902	5060	17962	5424	12538	-364
Prizren	3070	1926	4996	1693	2465	+233
Pejë	3790	2153	5943	1961	3982	+192
Ferizaj	2452	1852	4304	1690	2614	+162
Mitrovica	2506	1374	3880	1739	2141	-365
Gjakovë	1369	1274	2643	1221	1422	+53
Gjilan	2070	1553	3623	1779	1844	-226
Total	28159	15192	43351	15507	27844	-315

Tabela 8. Ngarkesa e gjykatave

8. Ngarkesa dhe efikasiteti i Gjyqtarëve sipas Gjykatave

Sa i përket ngarkesës me lëndë, gjatë vitit 2025, në nivel vendi, një gjyqtar i departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 677 lëndë. Megjithatë, sikurse edhe te prokuroritë, kjo mesatare nuk reflektohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha gjykatat, pasi dallimet ndërmjet tyre janë të theksuara.

Në disa gjykata, ngarkesa për gjyqtar është dukshëm më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Kjo vërehet veçanërisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë në të cilën një gjyqtar ka pasur mesatarisht 816 lëndë në punë, pasuar nga Peja me 742 dhe Prizreni me 713 lëndë për gjyqtar.

Ndërkaq, në disa gjykata të tjera, ngarkesa për gjyqtar është më e ulët se kjo mesatare. Ferizaj paraqitet me ngarkesën më të ulët prej 478 lëndësh për gjyqtar,

pasuar nga Gjakova me 492 dhe Gjilani me 517 lëndë për gjyqtar. Mitrovica, ndonëse me ngarkesë më të lartë se këto gjykata, sërish mbetet nën mesataren në nivel vendi me 646 lëndë për gjyqtar.

Ngarkesa më e madhe absolute me lëndë vazhdon të mbetet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila jo vetëm që ka pasur numrin më të madh të lëndëve në punë, por njëkohësisht ka edhe ngarkesën më të lartë mesatare për gjyqtar. Kjo tregon se, përkundër numrit më të madh të gjyqtarëve, kjo gjykatë vazhdon të përballet me numër të madh të lëndëve.

Me qëllim të balancimit të ngarkesës ndërmjet gjykatave, KGJK duhet të shqyrtojë mundësinë e transferimit të përkohshëm apo të përhershëm të gjyqtarëve nga gjykatat me ngarkesë më të ulët drejt atyre me ngarkesë më të lartë. Një qasje e tillë do të mundësonte shpërndarje më të drejtë të lëndëve, balancim të ngarkesës dhe përmirësim të efikasitetit në trajtimin e rasteve në departamentet e përgjithshme.

Gjykata	Lëndë në punë gjatë vitit 2025	Numri i gjyqtarëve	Mesatarja e lëndëve në punë për 1 gjyqtar
Prishtina	17962	22	816
Prizren	4996	7	713
Pejë	5943	8	742
Ferizaj	4304	9	478
Mitrovica	3880	6	646
Gjakovë	2643	5	492
Gjilan	3623	7	517
Total	43351	64	677

Tabela 9. Krahasimi i lëndëve në punë, me numrin e gjyqtarëve

Sa i përket efikasitetit, të dhënat tregojnë se edhe niveli i zgjidhjes së lëndëve dallon ndërmjet gjykatave themelore. Në nivel të përgjithshëm, një gjyqtar i departamenteve të përgjithshme ka zgjidhur mesatarisht 242 lëndë gjatë vitit

2025. Megjithatë, edhe kjo mesatare nuk reflektohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha gjykatat.

Efikasiteti më i lartë vërehet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, ku një gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht 289 lëndë, pasuar nga Gjilani me 254 lëndë të zgjidhura për gjyqtar. Më pas renditen Prishtina me 246, Peja me 245 dhe Gjakova me 244 lëndë të zgjidhura për gjyqtar, të cilat janë afër mesatares në nivel vendi.

Në anën tjetër, efikasitet më i ulët vërehet në Ferizaj në të cilën, një gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht 187 lëndë gjatë vitit 2025. Nën mesataren në nivel vendi mbetet edhe Prizreni me 241 lëndë të zgjidhura për gjyqtar, ndonëse ky i fundit është shumë afër mesatares së përgjithshme.

Gjykata	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2025	Numri i gjyqtarëve	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga 1 gjyqtar
Prishtina	5424	22	246
Prizren	1693	7	241
Pejë	1961	8	245
Ferizaj	1690	9	187
Mitrovica	1739	6	289
Gjakovë	1221	5	244
Gjilan	1779	7	254
Total	15507	64	242

Tabela 10. Krahasimi i numrit të lëndëve të zgjidhura, me numrin e gjyqtarëve

Sa i përket normës orientuese për gjyqtarët në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, ajo përcaktohet me Rregulloren Nr. 13/2025 përmes një sistemi pikëzimi, ku çdo lëndë vlerësohet me një numër të caktuar pikësh në varësi të mënyrës së përfundimit dhe kompleksitetit të saj. Në parim, lëndët standarde vlerësohen me 6.5 pikë, ndërsa ato që përfundojnë me procedura më të thjeshta (si urdhri ndëshkimor apo parashkrimi) marrin më pak pikë. Kurse, rastet më komplekse apo me më shumë të pandehur vlerësohen me më shumë pikë. Kështu, norma e punës së gjyqtarit nuk matet vetëm me numrin e lëndëve të

zgjdhura, por me totalin e pikëve të realizuara gjatë vitit, duke reflektuar më saktë ngarkesën dhe kompleksitetin e punës së tij.

Edhe në këtë rast, në efikasitetin e gjykatave ka mundur të reflektoj edhe fakti se disa prej gjyqtarëve të angazhuar në këto departamente kanë qenë gjyqtarë me mandat fillestar.

Numri i gjyqtarëve me mandat fillestar është si në vijim:

Gjykata	Gjyqtar me mandat fillestar
Prishtina	7
Prizren	1
Pejë	3
Ferizaj	3
Mitrovica	4
Gjakovë	3
Gjilan	3
Total	24

Tabela 11. Numri i gjyqtarëve me mandat fillestar gjatë vitit 2025

Në intervistat që ka realizuar “Betimi për Drejtësi”, me kryetarë të gjykatave themelore, u theksuan si problematike mungesat në stafin mbështetës administrativ, me theks të veçantë bashkëpunëtorëve profesionalë.¹¹

¹¹ “Salihu tregon sfidat me të cilat përballet Gjykata Themelore në Gjilan”. Betimi për Drejtësi. 2 Prill 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/salihu-tregon-sfidat-me-te-cilat-perballet-gjykata-themelore-ne-gjilan/>. & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjilan”, (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjilan/?fbclid=IwY2xjawRUXulleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNW15c3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHiYwV18hzwI0AJhhM9Xpt0GbEoXMKSb7NNjx8USNdIsT7Ns612DyJzznn8Yf_aem_Jk6ITA8NROEvBNSU791Mog); Intervista me kryetaren e GJTH në Gjakovë, Fëllanza Knuashaj & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjakovë”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjakove/?fbclid=IwY2xjawRUXx9leHRuA2FlbQIxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNW15c3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHknWQ7SVp1aLcl_7k53Y2iKN2S4wOu2niW2nVPtvbvEEEEJh2J_7LFaw0hCGi_aem_fc0cS3IQCWXIEB4Ipl0owQ); Kryetari i Gjykatës në Ferizaj: Jemi mirë me numrin e gjyqtarëve,

9. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në shkallë të parë

IKD ka analizuar edhe vjetërsinë e aktakuzave për të cilat gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime gjatë vitit 2025. Të dhënat tregojnë se përkundër faktit që numri më i madh i rasteve janë raste relativisht të reja, me mbizotrim të aktakuzave të ngritura gjatë viteve 2024 dhe 2025, në praktikë vazhdojnë të trajtohen edhe raste dukshëm më të vjetra, të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje për më shumë se një (1) dekadë.

Përkatësisht, nga 200 rastet e analizuara, në 61 raste, aktakuza është ngritur në vitin 2024, ndërsa në 56 raste në vitin 2025. Kjo tregon se pjesa më e madhe e aktgjykimeve të nxjerra gjatë vitit 2025 lidhen me raste të viteve të fundit.

Në anën tjetër, janë evidentuar edhe raste dukshëm më të vjetra, ku aktakuzat janë ngritur në vitin 2019 në pesë (5) raste, në vitin 2018 në një (1) rast dhe madje në vitin 2014 në dy (2) raste. Kjo nënkupton se në vitin 2025 gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime edhe për raste në të cilat aktakuza ishte ngritur mbi një dekadë më parë.

Në parim, trajtimi i rasteve sipas viteve të pranimit paraqet parakusht për trajtim të barabartë të tyre. Kështu, pa hyrë në specifikat e secilit rast veç e veç, ekzistimi i rasteve kaq të vjetra tregon se jo të gjitha rastet janë trajtuar me ritëm të njëjtë. Rrjedhimisht, përkundër faktit se shumica e rasteve të trajtuara gjatë vitit 2025 janë raste më të reja, prania e rasteve me aktakuza të ngritura shumë vite më parë mbetet shqetësuese në aspektin e trajtimit të barabartë të rasteve.

por jo me atë të bashkëpunëtorëve profesionalë". Betimi për Drejtësi. 15 mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-gjykates-ne-ferizaj-jemi-mire-me-numrin-e-gjyqtareve-por-jo-me-ate-te-bashkepuntereve-profesionale/>) & IKD, "Drejtesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-ferizaj/?fbclid=IwY2xjawRUYURleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJscVZLNzIzUTROYTdCNWl5c3J0YwZhcHBfaWQQMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoVTo8Zn6z-YDjoVneHfRt0oi4FtLElFVu3pG-dWSuO-MBTZjBGx7FI_9xXQ_aem_3-xn3WhVP2OJpg2eX4bNEA).

Viti kur është ngritur aktakuza	Numri i rasteve
2014	2
2018	1
2019	5
2020	8
2021	21
2022	18
2023	28
2024	61
2025	56

Tabela 12. Viti i ngritjes së aktakuzës në rastet e zgjidhura gjatë 2025

10. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në Gjykatë të Apelit

Për dallim nga gjykatat themelore, në Gjykatën e Apelit rastet më të vjetra të trajtuara gjatë vitit 2025 janë raste në të cilat aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerrë në vitin 2023, dhe të tilla janë vetëm katër (4) raste. Rastet tjera i përkasin aktgjykimeve të nxjerra nga gjykatat themelore në vitin 2024, gjithsej 55 raste, si dhe në vitin 2025, gjithsej 41 raste.

Pra, të dhënat tregojnë se në Gjykatën e Apelit dominojnë rastet relativisht të reja dhe se problematika e trajtimit të rasteve shumë të vjetra nuk është e theksuar sikurse në gjykatat themelore.

Viti kur është nxjerrë aktgjykimi i themelores	Numri i rasteve
2023	4
2024	55
2025	41

Tabela 13. Vjetërsia e lëndëve në Gjykatën e Apelit

Sa i përket kapaciteteve, në Gjykatën e Apelit u theksua nevoja për rritjen e stafit administrativ. Kryetari i kësaj gjykate, Valon Totaj, në intervistën për “*Betimi për Drejtësi*”, tha se obligimi që çdo gjyqtar/e të ketë një bashkëpunëtor profesional dhe një zyrtar ligjor, njëkohësisht duke shtuar se kjo Gjykatë është me specifike për shkak të juridiksionit që ka në tërë territorin e Republikës së Kosovës.¹²

11. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve

11.1. Në Gjykatat Themelore


Në nivel vendi, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve penale në departamentet e përgjithshme të gjykatave themelore paraqet një problematikë të veçantë. Nga të gjitha aktgjykimet e analizuara, rezulton se mesatarja e përgjithshme e trajtimit të rasteve është 672 ditë. Kjo kohëzgjatje tregon se trajtimi i rasteve penale vazhdon të zgjasë përtej një periudhe të arsyeshme kohore.

Megjithatë, të dhënat tregojnë për diskrepanca të theksuara ndërmjet gjykatave sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve. Në disa gjykata, mesatarja e trajtimit është dukshëm më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Kjo vërehet veçanërisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë me 1022 ditë dhe në Mitrovicë me 1001 ditë, ku trajtimi i rasteve zgjat pothuajse trefish më shumë krahasuar me disa gjykata tjera. Në këtë aspekt, duket se ka ndikuar numri i madh i lëndëve në punë që kanë këto dy gjykata. Kjo pasi përkundër faktit se të dy këto gjykata kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa mesatarja e përgjithshme, ngarkesa e madhe me lëndë ka bërë që

¹² “Totaj: Ndonjëherë është e pamundur që rastet të mos kthehen në rigjykim”. *Betimi për Drejtësi*. 10 mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/totaj-ndonjehere-eshte-e-pamundur-qe-rastet-te-mos-kthehen-ne-rigjykim/>). & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën e Apelit”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-e-apelit/?fbclid=IwY2xjawRUZAdleHRuA2FlbQIxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNW15c3J0YwZhcHBfaWQQMjIyMjM5Mjc4ODIwMDg5MgABHoOF34iFP4gQQ6Y6fJHVWDQN1keLVB7epDc4mbp8gH7YLnYMrpqQxuAh8iRj_aem_KDfKahSFyxb8pge69UvS”w).

kohëzgjatja e trajtimit të rasteve të jetë shumë problematike. Ky është një argument shtesë për nevojën e shqyrtimit të transferimit të gjyqtarëve nga KGJK, në mënyrë që të rritet dhe balancohet efikasiteti në trajtimit e rasteve.

Në anën tjetër, në disa gjykata kohëzgjatja e trajtimit është dukshëm më e ulët. Ferizaj paraqitet me mesataren më të ulët prej 327 ditësh, pasuar nga Gjakova me 335 dhe Gjlani me 364 ditë. Edhe Prizreni me 619 ditë dhe Peja me 688 ditë mbesin nën mesataren në nivel vendi, ndonëse më afër saj.



Grafika 1. Mesatarja e trajtimit të lëndëve nga Gjykatat

11.2. Në Gjykatën e Apelit

Nga 100 aktgjykimet e analizuara të Gjykatës së Apelit, rezulton se mesatarja e trajtimit të rasteve nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë deri në momentin e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të dytë ka qenë 210 ditë, apo rreth shtatë (7) muaj. Kjo tregon se, për dallim nga gjykatat themelore, trajtimi i rasteve në Gjykatën e Apelit është dukshëm më i shpejtë dhe nuk paraqet problematikë të theksuar.

Megjithatë, kur kjo mesatare prej 210 ditësh i shtohet mesatares prej 672 ditësh sa është kohëzgjatja e trajtimit të rasteve në departamentet e përgjithshme të gjykatave themelore, rezulton se nga momenti i ngritjes së aktakuzës deri në momentin e nxjerrjes së një aktgjykimi të formës së prerë kalojnë mesatarisht 882 ditë, apo rreth dy vjet e pesë muaj. Kjo kohëzgjatje, e parë në tërësi, tregon se përkundër faktit se në shkallë të dytë rastet trajtohen më shpejt, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës penale në këto raste mbetet e lartë.

12. Aplikimi i jurisprudencës së GJEDNJ në rastet e Gjykatave


Në rendin juridik kosovar, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore aplikohen sipas kuptimeve që jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) u ka dhënë këtyre të drejtave. Kjo sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila obligon institucionet që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore ti interpretojnë në përputhje me jurisprudencën e kësaj Gjykate¹³. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese (tutje: GJK) ka theksuar se *“sipas nenit 53 të Kushtetutës, gjykatat e Republikës së Kosovës, të gjitha pa përjashtim, e kanë për obligim që të interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Kjo do të thotë që, në të gjitha instancat kur GJK ose gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës i interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë, standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, duhet të zbatohen për këto të drejta dhe liri, kur kjo është e zbatueshme. Në rast konflikti midis të dyjave, standardet e vendosura nga GjEDNJ në interpretimin e KEDNJ-së, do të mbizotërojnë.¹⁴

Në lidhje me këtë, IKD ka analizuar aplikimin e jurisprudencës së GjEDNJ-së në 300 aktgjykime të nxjerra nga departamentet e përgjithshme të gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit. Të dhënat tregojnë se, në parim, kjo jurisprudencë nuk aplikohet fare në këto raste. Kjo pasi, nga 300 aktgjykimet e analizuar, vetëm në dy (2) raste, apo në 0.66% të rasteve të analizuar, është aplikuar jurisprudenca e GjEDNJ-së. Në të dyja këto raste aplikimi është bërë në mënyrë specifike. Për më tepër, të dy (2) këto raste janë aktgjykime të nxjerra nga GJTH në Mitrovicë. Ndërkaq, në asnjë aktgjykim të nxjerrë nga DP-të GjTh-ve të tjera apo nga Gjykata e Apelit nuk evidentohet aplikimi i jurisprudencës së GjEDNJ-së në aktgjykimet e nxjerra.

Kjo tregon se, përkundër obligimit të qartë kushtetues dhe standardit të vendosur edhe nga GJK, jurisprudenca e GjEDNJ-së vazhdon të mbetet pothuajse tërësisht jashtë praktikës së rregullt gjyqësore në trajtimin e rasteve penale nga departamentet e përgjithshme.

¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53

¹⁴ “AKTGJYKIM në rastin nr. KI207/19”. Gjykata Kushtetuese. Paragrafi 109. Prishtinë, 5 janar 2021. (Shih linkun: https://gjkapi.pbc.group/Custom/ki_207_19_agj_shq.pdf).



Grafika 2. Aplikimi i jurisprudencës së GJEDNJ në vendimet e gjykatave

Ndryshe, kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, në një intervistë për “*Betimi për Drejtësi*” ka bërë të ditur se ka një konkurs të hapur për tre (3) zyrtarë që do të themelojnë zyrën për monitorim dhe publikime, që përveç qëllimit për unifikimin e praktikës gjyqësore do jetë edhe në raport me praktikën e GJEDNJ-së.

Gjithashtu, sa i përket cilësisë së arsyetimeve, kryetari i GJTH në Gjilan, Venhar Salihu, e pranon se kjo mbetet sfidë ndërkohë që përmendi ndërmarrjen e hapave nga ata sa i përket analizimit të vendimeve të prishura dhe shkëmbimit të përvojave.¹⁵ Kryetarja e GJTH në Gjakovë, Fëllanza Knushaj, tha se janë të vetëdijshëm për kritikën dhe po punojnë në përmirësimin e cilësisë së arsyetimeve. Kurse, kryetari i Supremes, Fejzullah Rexhepi, thotë se sistemi ka qenë vetëkritik për këtë çështje dhe se ajo është trajtuar vazhdimisht.

13. Vendosja për kërkesën pasurore juridike

Mosvendosja e gjykatave në rastet penale edhe për kërkesën pasurore juridike konsiderohet problematike. Kjo mosvendosje gjatë procedurës penale bën që palët të detyrohen të ndjekin edhe një proces tjetër gjyqësor, atë civil, duke u zgjatur edhe më tutje realizimi i të drejtave të tyre. Kjo ndikon edhe në rëndimin e gjyqësorit me lëndë, duke krijuar raste të reja në procedurë civile, të cilat do mund të zgjidheshin në procedurë penale.

Sa i përket kësaj pjese, IKD ka gjetur se nga 156 raste penale, në të cilat ka pasur edhe palë të dëmtuara, gjykatat kanë vendosur edhe në raport me kërkesën

¹⁵ “*Cilësia e arsyetimit të vendimeve mbetet sfidë për Gjykatën në Gjilan, thotë Salihu*”. *Betimi për Drejtësi*. 02 Prill 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/cilesia-e-arsyetimit-te-vendimeve-mbetet-sfide-per-gjykatën-ne-gjilan-thote-salihu/>) & IKD, “*Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjilan*”, (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjilan/?fbclid=IwY2xjawRUYjllcHRuA2FlbQlXMAbicmlkETJscVZLNzlZUTROYTdCNWl5c3J0YwZhcHBfaWQQMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHqEOcg_6zEn3BosxPP1Mu0CFsckW2Q3cnYI77zFi5xeX0-6KJdZxUSPl-q60_aem_47wJTmiof_D2PBoQ2EdS1w).

pasurore juridike në vetëm katër (4) raste, apo 2.6% të rasteve. Kjo situatë tregon se mënyra e vendimmarrjes në këto raste dëmton të drejtat e të dëmtuarve, ndërsa njëkohësisht rëndon edhe më tej gjyqësorin.

Megjithatë, duhet theksuar se për të vendosur në lidhje me kërkesën pasurore juridike, palët e dëmtuara duhet të parashtrajnë një kërkesë të fillë. Në lidhje me këtë çështje, prej 200 aktgjykimeve të analizuara, në 156 raste ka pasur palë të dëmtuara. Sa i përket kërkesave pasurore juridike, në 23 raste palët kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike, ndërsa në 32 raste kanë hequr dorë nga kjo kërkesë. Për 101 rastet tjera, palët e dëmtuara nuk kanë prezantuar në seancë apo në aktgjykime nuk ka pasur informata lidhur me deklarinimin e tyre sa i përket kërkesës pasurore juridike.

Kështu, megjithëse vendimmarrja e gjykatave në raport me kërkesën pasurore juridike mbetet shumë e ulët, edhe parashtrimi i kërkesave pasurore juridike në gjykatë mbetet i fillë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që palët e dëmtuara, veçanërisht në rastet kur ato përfaqësohen nga avokat, të parashtrajnë kërkesa pasurore juridike, ndërsa gjykatat të vendosin edhe për këtë pjesë.

Gjykata	Ka pasur kërkesë pasurore juridike nga pala e dëmtuar	Është udhëzuar në kontest civil	Ka vendosur për kërkesën pasurore juridike
Prishtinë	4 raste	22	2
Prizren	0 raste	11	1
Pejë	5 raste	16	0
Ferizaj	7 raste	17	1
Mitrovicë	3 raste	12	0
Gjakovë	4 raste	18	0
Gjilan	0 raste	18	0
Total	23	114	4

Tabela 14. Vendosja për kërkesat pasurore juridike

14. Dënimet plotësuese

Dënimet plotësuese shtrijnë një efekt të gjerë në arritjen e qëllimit të dënimit, sidomos në parandalimin më efektiv të kryerësit të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen. Si përparësi e posaçme e dënimeve plotësuese në të drejtën penale, konsiderohet edhe fakti se me këto lloje të dënimeve, gjykatave u bëhet e mundur individualizimi më adekuat i sanksioneve penale dhe ofrojnë mundësi më të madhe për risocializimin e kryesit të veprës penale. Në këtë mënyrë, ideja e dënimeve plotësuese është që, në njëfarë forme, të mbushë hapësirat që i lejnë dënimet kryesore në arritjen e qëllimit të dënimit. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës ka sanksionuar gjithsej tetë (8) dënime plotësuese.


Nga 200 aktgjykime të analizuar, në vetëm gjashtë (6) raste është shqiptuar dënim plotësues, apo në 3% të rasteve. Prej tyre, në katër (4) raste është shqiptuar urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ndërsa në dy (2) raste është shqiptuar ndalimi i drejtimit të automjetit. Këto gjashtë dënime plotësuese janë shqiptuar vetëm nga dy gjykata, përkatësisht nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata Themelore në Pejë, me nga tri raste secila.

Kjo tregon se gjykatat vazhdojnë t'i përdorin shumë rrallë dënimet plotësuese, përkundër rolit që ato kanë në arritjen më të plotë të qëllimit të dënimit. Rrjedhimisht, këto sanksione, të cilat shërbejnë për individualizim më adekuat të dënimit dhe për parandalim më efektiv, në praktikë mbeten pothuajse të injoruara nga gjykatat.

Në këtë drejtim, gjykatat duhet të fokusohen më shumë në individualizimin e dënimit dhe, në secilin rast kur është e mundur dhe e arsyeshme, të vlerësojnë edhe shqiptimin e dënimeve plotësuese. Një qasje e tillë, do të ndikonte në forcimin e politikës ndëshkimore, specifikisht në arritjen më efektive të qëllimit të sanksioneve penale.



Grafika 3. Dënimet plotësuese



Grafika 4. Dënimet plotësuese të shqiptuara sipas gjykatave

15. Politika ndëshkimore

Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit në mënyrë të qartë ka elaboruar dispozitat lidhur me matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke ofruar pasqyrë të qartë mbi atë se si Gjykata duhet vepruar në secilin rast gjatë vendimmarrjes mbi dënimin. Udhëzuesi në mënyrë të detajuar ofron shpjegime sa i përket çdo rrethane të aplikuar si ato lehtësuese ashtu edhe rënduese, si dhe sqarime lidhur me qëllimin që synohet të arrihet përmes aplikimit të secilës rrethanë.

Lidhur me zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit, IKD ka analizuar 30 aktgjykime për vitin 2025. Nga kjo analizë rezulton se në të shumtën e rasteve, departamentet e përgjithshme – penal të gjykatave themelore kanë identifikuar dhe përfshirë në aktgjykime rrethanat lehtësuese e rënduese, mirëpo pa ofruar sqarime të hollësishme. Nga kjo analizë është vërejtur se në shumë raste, gjykatat kanë vepruar mbi bazën e një shablloni të përgjithshëm, pa bërë një individualizim specifik e adekuat për secilin rast të shqyrtuar.

15.1. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në DP gjatë vitit 2025

Gjatë analizimit të 30 aktgjykimeve të DP-Penal për vitin 2025, në 23 prej tyre është vërejtur aplikim i dyfishtë i rrethanave, ku përveç pranimi të fajësisë, të cilin gjykata e ka trajtuar si rrethanë lehtësuese, po ashtu janë përfshirë edhe keqardhja e pendimi. Sa i përket kësaj, Udhëzuesi i Gjykatës Supreme¹⁶ decidivisht thotë se gjykatat duhet të kenë kujdes të veçantë që të mos bëhet dyfishim i rrethanave, pasi që një praktikë e tillë do të përfundonte me shqiptimin e dënimit më të butë sesa ai meritor, ose dënim më të rëndë atëherë kur bëhet dyfishim i rrethanave rënduese. Një gjë të tillë, IKD e ka potencuar edhe në raporte tjera, duke bërë thirrje që gjykatat të kenë vëmendje të lartë gjatë aplikimit dhe arsyetimit të rrethanave lehtësuese e rënduese.¹⁷

Gjithashtu, një rrethanë e cila është hasur mjaft shpesh nga gjykatat është sjellja korrekte e kryerësit të veprës penale në gjykatë. Kjo rrethanë është aplikuar në shtatë (7) raste. Një rrethanë e tillë paraqet paqartësi thelbësore, kjo pasi që nuk mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese një sjellje e cila është detyrim ligjor. Një gjë e tillë është e potencuar edhe në udhëzues.¹⁸ Mirëpo, në rastet kur kryerësi i veprës penale, nuk respekton procedurën gjyqësore përkatësisht i shmanget ftesës së prokurorisë apo gjykatës atëherë kjo paraqet sinjal për sjellje jo të duhur të kryerësit si dhe mosrespektim të institucioneve,¹⁹ andaj edhe mund të merret si rrethanë rënduese, por në asnjë rast si rrethanë lehtësuese. Lidhur me rrethanat që kanë të bëjnë me aspektin personal të kryerësit të veprës penale, të njëjtat duhet të analizohen në mënyrë të detajuar e në përputhshmëri me faktet e rastit përkatësisht dëmin e shkaktuar si dhe përgjegjësinë e të njëjtit, e që në analizën e IKD-së është vërejtur se të njëjtat rrethana vetëm janë përmendur pa u dhënë një shpjegim më i detajuar sa i përket aplikimit të tyre.²⁰


¹⁶ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/Udhëzues_i_Përgjithshëm_për_Matjen_e_Dënimit). f. 87.

¹⁷ Krasniqi, Z. “Dënimet me gjobë – Leje për Armëmbajtje”. Insituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Shkurt 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/denimet-me-gjobe-lejeper-armembajtje/>); Shala, G. “Politika e Dënimeve në Kosovë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Nëntor 2019. (Shih linkun: [Politika-ndeshkimore](https://kli-ks.org/politika-ndeshkimore)); Krasniqi, Z./ Smajli, F. “Politika Ndëshkimore në Krimet Speciale”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/politika-ndeshkimore-ne-krimet-speciale/>); Zekaj, E. “Mos deklarimi i pasurisë, krim në letër, kundërvajtje në praktikë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Dhjetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/mos-deklarimi-i-pasurise-krim-ne-leter-kundervajtje-ne-praktike/>);

¹⁸ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/performanca-e-drejtises-ne-ndjekjen-dhe-gjykimin-e-korrupsionit/>). f.28.


¹⁹ Po aty.

²⁰ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/performanca-e-drejtises-ne-ndjekjen-dhe-gjykimin-e-korrupsionit/>). f.27.



Grafika 5. Aplikimi i rrethanave lehtësuese në DP-Penal

Në aktgjykimet e analizuara për vitin 2025, gjykatat kanë aplikuar si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, mënyrën e kryerjes së veprës penale, e të cilat janë parime mbi të cilat duke u bazuar edhe bëhet aplikimi i rrethanave rënduese.²¹ Ndërsa, si rrethanë rënduese në nëntë (9) raste janë aplikuar edhe shkalla e dashjes si dhe të qenurit recidivist.²² Në përfundim, gjykatat gjatë aplikimit të rrethanave rënduese nuk kanë bërë aplikim adekuat të rrethanave por në të shumtën e rasteve vetëm kanë përmendur parimet e përgjithshme mbi bazën e të cilave duhet të bëhet aplikimi i rrethanave rënduese.



Grafika 6. Aplikimi i rrethanave rënduese në DP-Penal

²¹ Po aty, f. 24

²² Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: [Udhëzuesi për matjen e dënimit Nentor 2024](#)). f.37.

15.2. Analiza e aktgjytimeve të Apelit sa i përket zbatimit të Udhëzuesit të Supremes

Gjykata e Apelit si shkallë e dytë, ka përgjegjësi e po ashtu detyrim që të shqyrtoj dhe vlerësoj aktgjykimet e shkallës së parë nëse janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe standardet e përcaktuara nga praktika gjyqësore. Megjithatë, nga analiza e dhjetë (10) aktgjytimeve, as shkalla e dytë nuk ka vepruar ndryshe nga ajo e shkallës së parë.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se në aktgjykimet e analizuara, Gjykata e Apelit ka vërtetuar dhe ka lënë në fuqi aktgjykimet e GJTH edhe në rastet kur në këto vendime nuk ishte bërë një aplikim adekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në përputhje me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme. Nga dhjetë (10) aktgjykimet e analizuara, në secilin rast është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë, pavarësisht se në të njëjtat janë vërejtur mangësi në arsyetimin dhe aplikimin e rrethanave, përfshirë raste të aplikimit të dyfishtë të rrethanave si dhe zbatim jo të duhur të Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për matjen e dënimit.

Si përfundim, gjetjet e këtij raporti lidhur me mungesën e unifikimit të politikës ndëshkimore dhe përdorimin jo të mjaftueshëm të Udhëzuesit për matjen e dënimit gjejnë mbështetje edhe në deklaratimet e kryetarëve të gjykatave.²³ Në

²³ “Raporti me mediat, trajtimi i lëndëve të korrupsionit e krimit të organizuar, flet Kryetari i Supremes “, Betimi për Drejtësi. 7 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/raporti-me-mediat-trajtimi-i-lendeve-te-korrupsionit-e-krimit-te-organizuar-flet-kryetari-i-supremes/>, & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme”, (shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>); Kryetari i Apelit: *Nuk jemi të kënaqur me harmonizimin e praktikave gjyqësore*. Betimi për Drejtësi. 10 mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-nuk-jemi-te-kenaqur-me-harmonizimin-e-pratikave-gjyqësore/>), & IKD, Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën e Apelit”, (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-e-apelit/?fbclid=IwY2xjawRUZAdleHRuA2FbQIxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZhcHBfaWQQMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoOF34iFP4gQQ6Y6fJHVWDQN1keLVB7epDe4mbp8gH7YLnYMrpqQxuAh8iRj_aem_KDfKahSFyxb8pge69UvStw); “Tahiri: Kur kemi dallime në dënime për çështje të njëjta, rrezikohet dhe cenohet parimi i sigurisë juridike”. Betimi për Drejtësi, 15 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/tahiri-kur-kemi-dallime-ne-denime-per-ceshtje-te-njejta-rrezikohet-dhe-cenohet-parimi-i-sigurise-juridike/>) & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj”. (shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-ferizaj/?fbclid=IwY2xjawRUYURleHRuA2FbQIxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZhcHBfaWQQMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoVTo8Zn6z-YDjoVneHfRt0oi4FtLE1FVu3pG-dWSuO-MBTZjBGx7FI_9xXQ_aem_3-xn3WhVP20Jpg2eX4bNEA); “Salihu: Rastet e korrupsionit sfiduese, problem edhe politika ndëshkimore”. Betimi për Drejtësi. 2 prill 2026. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/salihu-rastet-e-korrupsionit-sfiduese-problem-edhe-politika-ndeshkimore/>) & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjiilan”, <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjilan/?fbclid=IwY2xjawRUXulleHRuA2FbQIxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZhcHBfaW>

këtë drejtim, kryetari i GJTH në Ferizaj, Mustaf Tahiri, ka theksuar se politika ndëshkimore ka qenë jounike edhe brenda vetë gjykatës, duke theksuar se dallimet në dënime për çështje të njëjta cenojnë sigurinë juridike. Në të njëjtën linjë, edhe kryetari i GJTH në Gjilan, Venhar Salihu, ka theksuar nevojën për zbatim më të qëndrueshëm të këtij udhëzuesi në praktikë gjyqësore. Po ashtu, kryetari i Gjykatës së Apelit, Valon Totaj, ka vlerësuar se niveli i harmonizimit të praktikës gjyqësore nuk është i kënaqshëm, derisa kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi ka theksuar se Udhëzuesi për matjen e dënimit nuk ka gjetur zbatimin e pritshëm në praktikë.

